

STATUTI I
SHOQËRISË TREGTARE
"ALBI & GERTI" SH.P.K.

Sipas kërkesave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", është krijuar shoqëria tregtare "Albi & Gerti" sh.p.k., e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, nenet e këtij statuti.

Në këtë statut termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

Statuti: Statuti i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Albi & Gerti" sh.p.k.

Shoqëria: Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Albi & Gerti" sh.p.k.

Ligji Tregtar: Ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që shoqëria i drejton ortakëve sipas këtij statuti, do të bëhen me shkrim dhe do të konsiderohen se janë kryer në mënyrë të rregullt kur dërgohen ortakëve në adresat e deklaruara prej tyre pranë administratorit (ëve) të shoqërisë.

Në kuptim të këtij statuti, shprehjet në njëjës përfshijnë ato në shumës dhe anasjelltas me përjashtim të rastit kur sipas kontekstit të dispozitës rezultojnë ndryshe. Përemri vektor "ai" përfshin edhe përemrin vektor "ajo" dhe përemrin vektor "ate", nënkuptohen të dyja gjinitë me përjashtim të rasteve kur sipas kontekstit të dispozitës rezultojnë ndryshe.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1

Sot, më datë 11.01.2021, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "Albi & Gerti" sh.p.k.

Themelues të shoqërisë janë:

1. z. Alban Lleshi, i datëlindjes 01.04.1982, i biri i Esatit, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, i pajisur me kartë identiteti nr. I20401094H dhe
2. z. Gerti Lleshi, i datëlindjes 10.05.1978, i biri i Esatit, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë i pajisur me kartë identiteti nr. H80510081G,

Neni 2

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

1. Riparim telefonash dhe tregti aksesore të ndryshëm, importi i tyre.



Neni 3

Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të pacaktuar.

Neni 4

Shoqëria e ka selinë e saj në: Tiranë, Njësia Bashkiake nr.10, rruga e Bogdanëve, pallati me zone kadastrale 8350, nr.pasurie 3/218-N1, kati 1 dhe

Vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit : Tiranë, Njësia Bashkiake nr.10, rruga e Durrësit, pallati nr.60, kati 1, dyqani nr.33

Ajo mund të çelë dhe seli të tjera të dyta, degë e filiale, përfaqësi e agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë saj.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Njëqindmijë) lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues Albi Lleshi : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 60.000 (gjashtëdhjetmijë) lekë që përbën 60% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku themelues Gerti Lleshi : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 40.000 (dyzetmijë) lekë që përbën 40% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.



NENI 7

Transferimi i kapitalit.

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit;
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit thmeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit thmeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

NENI 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi më i lartë vendimor. Asambleja e përgjithshme e ortakëve merr vendime sa here e sheh të arsyeshme, por domosdoshmerisht për të miratuar pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administrator i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e tu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve , që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 përqind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" , ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 te nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmenduar më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votive të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- c) përcaktimin e shpërblimeve

- d) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë;
- Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 12

Administrimi

Administratorë të shoqërisë " Albi & Gerti " sh.p.k. emërohet z. Alban Lleshi, mbajtes i kartes se identitetit nr. I20401094H . Mandati i administratorit do të jetë 5 vjet nga data e miratimit të këtij statuti.

NENI 13

Kompetencat e Administratorëve

Administratori ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët për përmbushjen e aktivitetit të saj në përputhje me nenin 8 të këtij statuti.

Organi Administrativ (administratori) ka të drejtë dhe duhet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatitë dhe nënshkruajë pasqyrat financiare vjetore dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- f) marre në pune persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta.
- g) përfaqësojë apo emëroje përfaqësues në ceshtje gjyqesore qe mund të ketë shoqëria ose në ceshtje të tjera me palë të treta;

KREU IV

Neni 14

Viti financiar-ekspertët

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërise nisin vitin e parë në momentin e rregjistrimit në organet tatimore, ndërsa vite të tjera në 1 Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të cdo viti. Në fund të cdo periudhe ushtrimore hartohen pasqyrat financiare sipas ligjeve në fuqi. Pasqyrat financiare periodike mujore, tremujore, gjashtëmujore miratohen e nënshkruhen nga administratori i shoqërisë. Pasqyrat financiare vjetore miratohen nga asambleja e përgjithshme e ortakëve dhe nënshkruhen nga administratori.

Neni 15

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është i ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Neni 16

Fitimi neto i realizuar, pasi janë zbritur rezervat ligjore dhe tatimet sipas ligjeve në fuqi, mbetet në përdorim ortakëve të cilët vendosin për përdorimin e tij.

KREU V

MARËDHËNIET E PUNËS

Neni 17

Marëdhëniet e punës në këtë shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratës së punës. Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut do zbatohen dispozitat e Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë. Mosmarrëveshjet e punonjësve me shoqërinë do të zgjidhen në gjykatën shqiptare. Punonjësit e emëruar nuk marrin pjesë në ndarjen e fitimit të realizuar nga shoqëria gjatë aktivitetit të saj, nëse në kontratë nuk është parashikuar ndryshe. Për punën e kryer punonjësit marrin pagë siç është parashikuar në kontratë.

KREU VI

Prishja dhe likuidimi

Neni 18

Veprimtaria e shoqërisë pushon me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të shoqërisë për shkaqet:

- sipas rasteve të parashikuara nga Ligji Tregtar
- pamundësi veprimi
- shpërndahet me vullnetin e ortakëve.
- riorganizohet në një formë tjetër.

Neni 19

Shoqëria do të ketë statutin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe do të përballojë humbje deri në kufirin e kontributit të themeluesve të saj në kapitalin fillestar.

Neni 20

Në kushtet e nenit 23 të këtij statuti Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve cakton një ose më shumë likuidatorë të cilët marrin në dorë drejtimin e shoqërisë duke kryer të gjitha veprimet e likuidimit të saj, duke likuiduar në radhë të parë detyrimet ndaj shtetit e më pas ndaj të tretëve. Në rastin e tepricës së kapitalit të shoqërisë me perfundimin e likuidimit, kjo i shpërndahet ortakëve. Ndërsa në rastin e pamjaftueshmërisë së kapitalit, ortakët e shoqërisë janë të detyruar të derdhin kuotat e tyre deri në nivelin e kuotave të kapitali themeltar.

Neni 21

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në shoqëri me të tretët , zgjidhen me pajtim, në të kundërt palët i drejtohen Gjykatës për zgjidhje.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Per sa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimeve që do të bëjnë ortakët e shoqërisë si dhe ligjeve të vecanta në të cilat është referuar hartimi i këtij statuti.

Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyre e procedurë me të cilën nxirret vetë statuti.

Neni 23

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statute, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 24

Ky statut u përpilua në prani të ortakëve të shoqërisë duke shprehur vullnetin e tyre të plotë e të lirë.

Ai u përpilua në katër kopje me fuqi të barabarta secila, për t'u depozituar në QKB e për tu shpërndarë në organet kompetente dhe një kopje mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Neni 25

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Tiranë më 11.01.2021

ORTAKËT E SHOQËRISË "ALBI & GERTI " SH.P.K.

z. Alban Lleshi

ALBAN LLESHI



z. Gerti Lleshi

GERTI LLESHI

